



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Istogut (KI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kundërt, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, nuk prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion të kundërt

Çështjet materiale që kanë ndikuar opinionin janë si në vijim:

- B1 Pasqyrat Financiare Vjetore nuk prezantojnë një informacion të plotë dhe të saktë, ato përmbajnë gabime në raportimin e zërave kontabël nëpër pozicione të caktuara.
- B2 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale të prezantuara në PFV ishin të nënvlerësuara për 593,987€.
- B3 Keqklasifikimi i shpenzimeve nëpër kategoritë ekonomike në vlerë 120,970€.
- A1 Prezantim jo i saktë i Llogarive të Arkëtueshme në PFV për 54,928€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Istogut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Çështjet materiale që kanë ndikuar konkluzionin janë si në vijim:

- B4 Si pasojë e vonesës në pagesën e detyrimeve financiare komuna kishte paguar shpenzime shtesë prej 24,015€ në emër të procedurës kontestimore/përmbartimore.
- A2 Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 22 zyrtarë për shërbime të veçanta, pa udhëhequr procedurë të prokurimit.
- B5 Komuna nuk kishte përgatitur plan vjetor për subvencionimin e OJQ-ve.
- A3 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme dhe nuk ka bërë shqyrtimin e ankesave brenda afatit të përcaktuar kohor.
- B6 Mos zbatim i rregullores për subvencione, përfshirë thirrjen publike, dhënien e subvencionit dhe monitorimin e subvencioneve.
- B7 Njësit kërkuese kishin iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë pa hartuar projekt ekzekutiv.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunes është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Istogut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Istogut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Istogut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Istogut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Istogut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: përgatitja e PFV-ve në pajtim me kërkesat ligjore, të hyrat, mos respektimi i procedurave të prokurimit, të arkëtueshmet, mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV, keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate, si dhe regjistrimi i pasurisë jo financiare, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ne gjatë procesit të auditimit, i kemi rekomanduar komunës për ti korrigjuar PFV, mirëpo ato nuk janë korrigjuar. Kjo situatë ka ndikuar që opinioni i auditimit të jetë i kundërt.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja dhe nëntë (9) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Prezantimi jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PFV

Gjetja

Neni 6i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Komuna nuk mbanë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar të LLogarive të Arkëtueshme (LI.A) dhe si rrjedhojë LI.A për Lejet ndërtimore në PFV, janë të nënvlerësuara për 24,350€, pasi që në regjistrin që është prezantuar, vlera e LI.A ishte 36,556€, ndërsa komuna në PFV ka prezantuar shumën 12,206€.

Poashtu edhe LL.A për shfrytëzimin e pronës komunale në PFV, janë të nënvlerësuara për 23,276€, pasi që komuna në PFV ka prezantuar shumën 10,440€, ndërsa në regjistër të LI.A është prezantuar vlera 33,716€.

LL.A për tatimin në pronë janë mbivlerësuar për 7,302€, për një pronë e cila është në pronësi të institucioneve të Republikës së Kosovës e cila është e liruar nga tatimi në prone.

Prezantimi jo i drejt i LL.A në PFV, kishte ndodhur për shkak se nuk kanë funksionuar kontrollet e brendshme në mes të personave përgjegjës për mbajtjen e regjistrave të Llogarive të arkëtueshme dhe ZKF-së, me rastin prezantimit të tyre në PFV.

Ndikimi Prezantimi i LL.A në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e LL.A.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj që Llogarit e arketueshme të prezantohen në pasqyrat financiare, sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore. Po ashtu, duhet të siguroj se personat përgjegjës për mbajtjen e regjistrave të Llogarive të arketushme dhe Zyrtari Kryesor Financiar bashkëpunojnë dhe japin vlera të sakta të Llogarive të arketushme me rastin prezantimit të tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Prezantim jo i saktë i të dhënave në PFV

Gjetja Sipas neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Nga rishikimi i PFV-e kemi identifikuar gabimet si në vijim:

- Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa hyrja e parasë së gatshme, shtylla buxheti fillestar dhe buxheti final, shënimi 9, të hyrat jo tatimore, është prezantuar shuma prej 606,000€, ndërsa sipas ligjit të buxhetit është dashtë të prezantohet shuma 638,553€, ky shënim është nënvlerësuar për 32,553€;
- Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa hyrja e parasë së gatshme, shtylla buxheti fillestar, shënimi 12, të tjera, është prezantuar gabimisht vlera prej 33,000€, kjo vlerë duhej ti shtohet shënimit 9 të hyrave jo tatimore;
- Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa dalja e parasë së gatshme, shtylla e buxhetit fillestar, shënimi 6 shpenzimet kapitale, është prezantuar vlera 2,764,191€ si buxhet fillestar për këtë kategori, ndërsa sipas ligjit të buxhetit duhej të ishte vlera 4,437,313€. Këtu, nuk është përfshirë klauzola e investimeve që është 1,673,122€, që është dashtë të përfshihet te kjo kategori si buxhet fillestar, pasi që, klauzola është prezantuar në ligjin e buxhetit. Kjo pastaj ka reflektuar edhe tek totali i buxhetit fillestar, ku komuna ka prezantuar si buxhet fillestar vlerën 11,076,000€, ndërsa duhej të prezantohet 12,749,122€ sipas ligjit buxhetit;
- Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, kolonat e bartjeve për vitet 2020 dhe 2019, tek këto shtylla janë prezentuar shënimet e viteve 2019 përkatësisht 2018;
- Te neni 14.6- Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, nuk janë bërë harmonizimet e buxhetit siç kërkohet te kjo tabelë;
- Te shpalosjet neni 13 pagesat nga palët e treta, komuna ka prezantuar vlerën 432,783€, ndërsa nuk ka regjistruar asnjë pagesë nga palët e treta në thesar;
- Te neni 18 detyrimet kontigjente, komuna ka prezantuar në PFV shumë prej 621,000€, por regjistri analitik i detyrimeve kontigjente i siguruar nga komuna prezanton vlerën prej 435,602€ me një diferencë 185,398€, ndërsa nga mostrat e testuara kemi vërejtur se

210,836€ ishin vendime të formës së prerë dhe të cilat ishin ekzekutuar nga thesari sipas vendimit përmbartimor e të cilat ishin pjesë regjistrit të detyrimeve kontigjente të prezantuar në PFV. Pra detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 396,234€; dhe

- Te neni 19.3.1 Pasuritë kapitale, komuna nuk ka prezantuar saktë totalin e pasurive kapitale për vitin 2020 dhe 2019, për vitin 2020 kishte prezantuar 105,806,000€ në vend që të prezantonte 111,960,249€, dhe për vitin 2019 kishte prezantuar 20,746,000€ në vend që të prezantonte 21,403,153€.

Dobësitë rreth hartimit të PFV-ve janë duke u përsëritur, me gjithë sugjerimet nga auditimi për korigjime. Zyrtarët komunal nuk kanë dhënë sqarime për parregullësitë në PFV. Megjithatë, e gjithë kjo rezulton në neglizhencën e personit përgjegjës në komunë lidhur me hartimin e PFV-ve dhe mos funksionimit të kontrolleve.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë i PFV-ve, pamundëson që lexuesit të kuptojnë gjendjen e saktë të Komunës. Po ashtu, mungesa e informatave të plota në shënime shpjeguese në pasqyrat financiare ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë përgatitjes së PFV-ve, në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime dhe të ndërmer masa adekuate ndaj personave përgjegjës për mos prezantim të saktë të të dhënave në PFV për dy vite radhazi. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet, nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PFV-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos regjistrimi i pasurive dhe prezantimi jo i plotë i tyre në PFV

Gjetja

Sipas Rregullores nr. 02/2013 - "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria",

Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrat kontabël të SIMFK-së blerjet e vitit 2021 që janë bërë për pasuri kapitale dhe jo kapitale në vlerë prej 593,987€* (ku përfshihen asfaltimi i rrugëve lokale, ndërtimi i objekteve arsimore dhe shëndetësore, etj). Po ashtu, Komuna nuk e aplikon sistemin e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€, duke bërë që vlera e pasurive kapitale dhe jo kapitale të mos jetë e shpalosur saktë në PFV.

Zyrtarët komunal, nuk kanë ofruar shpjegime për mos zbatim të kërkesës ligjore. Megjithatë, ndonëse rekomandimi përsëritet, komuna nuk ka treguar interesim që këtë situatë ta menaxhojë dhe të evitohen gabimet e përsëritura.

Ndikimi

Mos regjistrimi i të gjitha pasurive, rritë rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll, të gjitha asetet e saj dhe të ketë mangësi në raportim duke bërë nënvlerësimin e pasurive në PFV.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë në mënyrë që të ulet rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, sistemi e-pasuria duhet të përdoret për evidentimin e pasurive nën 1000€.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t’i aplikojnë.

Keq klasifikimet e shpenzimeve nëpër kategori ekonomike jo adekuate ishin në vlerë 120,970€, si:

- Nga kategori e investimeve kapitale 65,892€, ishin paguar për mallra dhe shërbime dhe 7,470€ për subvencione dhe transfere; dhe
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, 47,608€ ishin paguar për paga dhe mëditje për punëtorët jashtë listës së pagave me të cilët komuna kishte kontrata të rregullta pune sipas ligjit të punës.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyra Vjetore Financiare.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedurat të veçanta ligjore

Gjetja Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, përcakton se, “Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik”.

Komuna gjatë vitit 2021, kishte të angazhuar 22 zyrtarë me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV). Nga ky numër, 21 persona ishin të angazhuar edhe në vitin 2020. Këto marrëveshje janë vazhduar edhe gjatë vitit 2021, por pa procedurë të prokurimit. Këta zyrtarë ishin angazhuar për pozitat si: zyrtar për tatim në pronë, zyrtar për siguri të Teknologjisë Informative, zjarrfikës, Inspektor i komunikacionit rrugorë, doktor i mjekësisë veterinarë, etj. Në një rast të angazhimit me MSHV në vitin 2021 për pozitën zyrtar për subvencione, ishin zbatuar procedurat e rekrutimit sipas Ligjit të shërbimit civil dhe jo sipas nenit 84 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114.

Sipas menaxhmentit, arsyeja përse nuk i kanë zhvilluar procedurat e prokurimit, ishte se këta zyrtar ishin të angazhuar edhe më parë, ku janë zhvilluar procedura të thjeshtuara të rekrutimit.

Ndikimi Moszbatimi i kritereve të përcaktuara ligjore për angazhimin e personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, mund të cenon parimin e konkurrencës, transparencës si dhe mund të ndikoj në diskriminimin e të tjerëve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta, duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë për pozita jo të rregullta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos verifikimi i 20% i pronave të tatimit në pronë

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.

Komuna e Istogut kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për 26,612 objekte dhe parcela. Komuna në vitin 2021, kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e rreth 4% të pronave.

Verifikimi jo i plotë i pronave mund të jenë indikacion (sipas komunës) për

shkak të stafit të pamjaftueshëm, por edhe për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar përqindja e inspektimeve është ende më e ulët.

Ndikimi Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në pagimin e faturave dhe kostot e procedurave përmbartimore

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për LMFP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Në 10 raste të testuara, kemi vërejtur se komuna nuk kishte paguar brenda afatit kohor obligimet e papaguara, vonesat ishin deri gjashtë muaj.

Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa nga buxheti i komunës për vitin 2021 në vlerë prej 554,647€. Prej tyre 530,632€ ishte borxhi kryesor i papaguar i komunës, kurse 24,015€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës kontestimore / përmbartimore apo interesit.

Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe kontrollit të dobët në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, ka ndikuar që Komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore për Komunën.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhen vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare / subvencionim

Gjetja Rregullorja MF -04/2017- për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve. Neni 6, pika 1 - “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë ZKM-së”.

Komuna nuk kishte përgatitur plan vjetor për subvencionimin e OJQ-ve, i cili do duhej të dorëzohet pranë zyrës së Kryeministrit edhe pse ka bërë subvencionim të OJQ-ve.

Kjo kishte ndodhur pasi që Zyrtari Kryesor Administrativ nuk kishte deleguar përgjegjësi për hartimin e planit për financim të OJQ-ve tek përgjegjësit e programeve që bëjnë shpërndarje të subvencioneve.

Ndikimi Mungesa e planit vjetor të subvencioneve pamundëson informimin me kohë të palëve të interesuara rreth programit vjetor dhe objektivave që synohen të arrihen përmes financimit të projekteve.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të siguroj përbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, dhe raportimin e planit në ZKM në afatin e përcaktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B6 - Subvencioni, thirrja publike dhe monitorimi i subvencioneve në kundërshtim me rregulloren**

Gjetja Sipas nenit 2.1 të rregullorës MF-nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, përcakton që Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve, të cilat janë aplikues apo partner në aplikimet, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, dhe të cilat i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje. Dhe neni 13, përcakton kriteret të cilat duhet ti përmbajë⁵ thirrja publike si: Formularin 9/projekt-propozimin, Formularin 10/projekt buxhetin, të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes etj. Po ashtu, sipas nenit 23.1 të rregullorës së njëjtë, Monitorimi dhe raportimi i projekteve dhe programeve përcakton se “Për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Ndërsa në pikën 2 kërkohet nga përfituesi të raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës.

Lidhur me këtë kemi identifikuar se:

- Pagesa prej 5,315€ ishte bërë sipas vendimit të kryetarit, për përkrahje financiare të Klubit të hendbollit të femrave për pjesëmarrje në EHF Cup, duke anashkaluar Rregulloren MF nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ku kërkohet konkurrueshmëri, transparencë, trajtim i barabartë dhe mos

diskriminim.

- Me një thirrje publike për subvencionimin e aktiviteteve sportive kemi identifikuar se katër OJQ nga kjo thirrje, janë përzgjedhur dhe kanë përfituar subvencion në shumë prej 33,493€ pa përgatitur projekt propozim, projekt buxhet dhe pa të dhënat për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes. Po ashtu, këto OJQ nuk kanë dorëzuar raporte kthyesë financiare dhe narrative për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.
- Thirrja publike për subvencionim të aktiviteteve sportive nuk ishte në përputhje me rregulloren pasi që nuk përmbante: Formularin 9/projekt-propozimin, Formularin 10/projekt buxhetin, dhe të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes.

Shkak i kësaj ishte mos funksionimi i mirë i kontrolleve të brendshme, mungesa e zyrtarit monitorues, si dhe mos caktimi i një afati kohor të raportimit në kontratë.

Ndikimi	Mos respektimi i kriterëve sipas thirrjes publike, si dhe mungesa e monitorimit të subvencioneve, rritë rrezikun që mjetet buxhetore të ndahen dhe shpenzohen në kundërshtim me objektivat e Komunës.
Rekomandimi B6	Kryetari duhet të siguroj që thirrjet publike për subvencionim të përmbajnë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, pastaj të kërkoj nga OJQ-të të dorëzojnë raporte kthyesë financiare dhe narrative si dhe për çdo përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja	Sipas nenit 28,10 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues (AK) është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë AK nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.
---------------	--

Te kontratat "Ndërtimi i veshtoreve në stadiumin e futbollit Demush Mavraj - Istog-faza e dytë, 69,835€", "Ndërtimi i rrugëve Fushë Kuqe dhe Molla Kuqe në Kovrag (projekt 2 vjeçar), 79,412€", dhe "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe ndriçimit publik në lagjen Arif Ademi në Banjë, Carrallukë dhe asfaltimi i rrugëve në Komunën e Istogut 102,987€", komuna nuk kishte hartuar projekt ekzekutiv, por kishte inicuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë.

Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njërive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

Ndikimi	Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj me realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të afektojë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për parane e
----------------	--

shpenzuar.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurohet se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e projektit ekzekutiv sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin në vlerë 1,072,090€ dhe kanë pasur një rritje prej 284,783€ në krahasim me vitin 2020, ku të hyrat ishin 787,307€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga gjobat në trafik në vlerë prej 131,893€, gjobat e gjykatave 29,941€ dhe të hyrat nga agjencia e pyjeve 11,908€.

Çështja B8 - Mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore nga tatimi në pronë

Gjetja

Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronë të paluajtshme, përcakton që "Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohe zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit", si dhe paragrafi 4 përcakton që "Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim 2 (dy) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme".

Nga analiza e bazës së shënimeve të Protax-it, kemi konstatuar se janë 282 objekte të kategorisë së pronës "Për afarizëm" (kategoria e vlerësimit: zyre), ku tatimpaguesit i llogaritet zbritja gabimisht pasi që përfitojnë nga zbritja e banimit primar 15,000€, vlera gjithsej e regjistruar për zbritje është 4,230,000€ dhe nëse kalkulohe zbritja e ngarkesës për këtë vlerë del se komuna kalkulon 6,345€ tatim më pak në vit ($4,230,000 * 0.15\% = 6,345€$).

Më tutje, bazuar në kërkesat e sistemit Protax, dosja e tatimpaguesit duhet të përmbajë elementet si në vijim: numrin personal ID, numrin e tatimpaguesit, pronës, ndërtesës, fotografi etj. Ne kemi verifikuar se 2,120 tatimpagues nuk e kanë të vendosur numrin e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, por janë vendosur vetëm numra me zero sa për të kaluar këtë hap.

Shkaku i ndodhjes është neglizhenca e zyrtarëve kompetent për kompletimin e dosjeve të tatimpaguesve.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar në bazën e të dhënave dhe informatat e mangëta në dosjen e tatimpagueseve përfshirë numrin personal, ndikon në mundësin e përfutimit të zbritjes së vendbanimit parësore në më shumë se një prone dhe kjo pastaj rezulton që komuna të ngarkoj me tatim tatimpaguesit më pak se sa duhet.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax. Gabimet dhe defektet që ndodhin në sistemin Protax duhet të trajtohen dhe zgjidhen në bashkëpunim me Departamentin e Tatimit në Pronë në kuadër të ministrisë së financave punës dhe transfereve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbimet komunale ishte 1,550,850€, prej tyre ishin shpenzuar 1,385,073€ ose 89%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, derivate dhe lëndë tjera për ngrohje, komunal, mirëmbajtje të objekteve dhe shpenzime kontraktuese tjera, etj.

Çështja A4 - Pagesa e parregullt përmes procedurës përbarimore

Gjetja

Sipas nenit 24 të rregullës financiare nr.01/2013/mf - shpenzimi i parave publike, të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat kontrollit të brendshme për qarkullim të dokumentacionit. Paragrafi 1.2 Të siguroj raportin e pranimit të mallit /shërbimit nga zyrtari / komisioni i autorizuar dhe paragrafi 1.3 Fatura të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave.

Thesari sipas urdhërit përbarimor, kishte ekzekutuar pagesën me vlerë prej 5,107€, së bashku me koston shtesë 987€. Mirëpo, te kjo faturë nuk ka raport që punimet janë përfunduar dhe pranuar nga zyrtari mbikëqyrës apo menaxheri i kontratës, dhe po ashtu për këtë nuk ka dëshmi se fatura ishte pranuar dhe protokolluar nga komuna. Zyrtari përgjegjës për përfaqësim të komunës kishte paraqitur prapësim të urdhrit përbarimor, mirëpo atë e kishte bërë pas afatit të përcaktuar ligjor, për çka edhe gjykata e kishte refuzuar prapësimin dhe pagesa ishte ekzekutuar nga thesari.

Sipas përfaqësuesit juridik të komunës, kjo ka ndodhur për shkak volumit të madh të punëve të avokatit.

Ndikimi

Si pasoj e mos ndërmarrjes së veprimeve adekuate për mbrojtjen e interesit të komunës brenda afatit kohor për prapësimin e propozimit për përbarim, buxheti i komunës është dëmtuar me 5,107€.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të siguroj se përfaqësuesi juridik i komunës, ndërmerr veprimet e nevojshme brenda afateve kohore në rastet kur është i nevojshëm përfaqësimi juridikë i komunës për tu mbrojtur interesi i Komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2021, ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,632,691€. Kjo vlerë përbehet nga Tatimi në pronë 1,424,174€, Lejet e ndërtimit 12,206€, ngarkesa për afarizëm të biznesit 174,831€ dhe të tjera 21,480€.

Çështja B9 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme dhe mungesa e mekanizmave për arkëtimin e tyre

Gjetja

Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr.06/L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Sipas nenit 12.3 të Rregullores nr. 2/2021 - për taksa tarifa dhe gjoba komunale, përcaktohet që për mospagimin e taksave dhe ngarkesa të përcaktuara në rregullore, në afatin të cilin e përcakton organi zyrtar përkatës, për të cilat ka faturë iniciohet procedura përmbarese.

Komuna nuk ka arritur të përgatit një plan operativ për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme (LL.A) dhe nuk ka ndërmarr veprimet e kërkuara sipas legjislacionit. LL.A krahasuar me vitin e kaluar janë rritur në masën prej 9%, rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë, ku borxhet e pa mbledhura ishin 1,424,174€ dhe krahasuar me vitin 2020 ishin rritur për 146,792€ apo 11%.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e LL.A në Taksën për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, pasi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për arkëtimin e borxheve të grumbulluara ndër vite. Vlera e tyre e prezantuar në PFV 2021 ishte 174,831€ dhe është e njëjtë me shumën e prezantuar edhe në vitin 2020.

Megjithëse edhe vitet paraprake nuk ishte gjendja e mirë e menaxhimit të LL.A, në këtë vit ka ndikuar edhe gjendja e krijuar me Covid-19.

Ndikimi

Rritja e LLA nëpër vite, dhe mos marrja e veprimeve për inkasim të tyre, ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të këtyre llogarive dhe nga ana tjetër ndikohet trendi negativ i rritjes vit pas viti duke rrezikuar arkëtimin e tyre.

Rekomandimi B9

Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë. NjAB për vitin 2021 kishte planifikuar katër auditime të cilat deri në fund të vitit i kishte finalizuar dy raporte për fushat: Prona dhe të hyra nga urbanizmi.

Çështja A5 - Përbërja jo e plotë dhe mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Sipas nenit 6 të UA MF- nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit (KA) në subjektin e sektorit publik, KA emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë. Dhe sipas neni 8, KA duhet të mbajë së paku katër mbledhje brenda vitit kalendarik, për të shqyrtuar rekomandimet nga raportet e Auditimit të brendshëm dhe Auditimit të jashtëm.

KA përbëhet vetëm me dy anëtarë nga tre që është minimumi i kërkuar, nga shtatori i vitit 2020 kur i ka skaduar mandati kryesuesit të KA, komuna nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për zëvendësimin e tij.

Për vitin 2021, KA kishte mbajtur vetëm dy takim/mbledhje nga katër që ka obligim, duke pamundësuar ndihmën për menaxhmentin e komunës në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shqyrtimin e raporteve dhe dhënien e mbështetjes së NjAB-së.

Shkaqet e mos funksionimit të KA, nuk janë sqaruar nga ana e zyrtarëve komunal. Megjithatë, vërehet se komuna nuk i ka kushtuar vëmendje kësaj situate.

Ndikimi

Përbërja jo e plotë e KA dhe mos funksionimi i vazhdueshëm i KA, ndikon negativisht në efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës dhe funksionimin e auditimit të brendshëm.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të siguroj veprimet e nevojshme që KA të ketë përbërje të plotë dhe të siguroj funksionimin e KA-së në mënyrë që komiteti të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, KA duhet të monitoroj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^e	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	12,749,113	12,672,563	11,920,156	13,665,096	11,298,093
Grante Qeveritare - Buxheti	10,001,812	9,849,621	9,385,694	9,897,884	9,047,397
Financimi përmes huamarrjes	0	25,035	25,031	92,580	0
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,673,122	1,673,122	1,528,317	2,402,275	1,018,849
Të bartura nga viti i kaluar	0	0	0	426,373	357,316
Të hyrat vetanake	1,074,179	1,074,179	941,700	638,792	834,100
Donacionet vendore	0	50,083	39,414	31,545	40,430
Donacionet e jashtme	0	523	0	175,649	0

Buxheti final është më i ultë se buxheti fillestar për 76,550€. Ky zvogëlim rezulton nga ulja e grantit të Qeverisë për 152,191€, rritjes së financimit nga huamarrja për 25,035€ dhe rritjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme për 50,606€.

Në vitin 2021 komuna e Istogut ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar ose 11,920,156€ me një përmirësim prej 5% në krahasim me vitin 2020, ku realizimi ishte 89%. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	12,749,113	12,672,563	11,920,156	13,665,096	11,298,093
Pagat dhe mëditjet	6,309,800	6,166,854	6,160,659	6,211,773	5,932,592
Mallrat dhe shërbimet	1,350,000	1,348,850	1,227,191	1,482,803	1,164,195
Komunalitë	202,000	202,000	157,882	174,280	154,686
Subvencionet dhe transferet	310,000	325,000	321,811	315,008	328,610
Investimet Kapitale	4,437,313	4,629,859	4,052,614	5,481,234	3,718,008
Rezervat	140,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 142,946€. Kjo rezulton nga zvogëlimi i grantit qeveritar prej 166,041€, dhe rritjes nga financimi nga Huamarrja prej 23,095€;
 - Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,150€, ndërsa buxheti i realizuar për këtë kategori ishte 91%. Ky ndryshim buxhetor është nga zvogëlimi i granti qeveritar për të njëjtën shumë;
 - Buxheti final për subvencione kishte rritje për 15,000€, kjo rritje ishte nga granti qeveritar, ndërsa buxheti i realizuar për këtë kategori ishte 99%;
 - Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 192,546€, përkundër rritjes së buxhetit, realizimi ishte në nivelin prej 88%. Kjo rritje ishte nga rezerva prej grantit 140,000€ dhe nga granti donator dhe huamarrja prej 52,546€. Këto mjete me vendim të Asamblesë Komunale ishin planifikuar të shpenzohen kryesisht për projektet: Shtrimi i rrugëve lokale, Ndërtimi, rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale.
- Vlen të theksohet se projekti Ndërtimi i skemës për furnizim me ujë në Komunën e Istogut në vlerë 5,094,246€, financohet nga klauzola e investimeve. Për këtë projekt Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2019 kishte miratuar Ligjin Nr. 06/L-143 për ratifikimin e marrëveshjes për kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG. Nga vitin 2019 deri në 2021, ishin shpenzuar 3,421,124€, ndërsa vetëm për vitin 2021 ishin shpenzuar 1,528,317€.
- Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 208,112€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin në vlerë 1,072,090€ dhe kanë pasur një rritje prej 284,782€ në krahasim me vitin 2020. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga gjobat në trafik në vlerë prej 131,893€, gjobat e gjykatave 29,941€ dhe të hyrat nga agjencia e pyjeve 11,908€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	1,074,179	1,074,179	1,072,090	787,307	1,083,543
Të hyrat tatimore	435,626	435,626	474,062	299,468	395,940
Të hyrat jo tatimore	638,553	638,553	598,028	487,840	687,602

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Istogut ka rezultuar në 11 rekomandime kryesore. Komuna e Istogut kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Komuna nuk kishte mbajtur ndonjë dëgjim publik lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA.

Komuna nuk kishte përgatitur asnjë raport periodik rreth zbatimit të rekomandimeve siç kërkohen me rregulloren e ZKA-së për hartimi e raporteve të vlerësimit lidhur me zbatimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, dy (2) rekomandime janë zbatuar dhe nëntë (9) të pazbatuara, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë përgatitjes së PFV në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ngritë kontrolle shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj që gjatë subvencionimit të respektohen rregulloret në fuqi, gjithashtu duhet të inicioj procedura për vendosjen e kritereve për vlerësimin e kërkesave dhe ndarjen e subvencioneve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.	Nga testimet tona nuk kemi vërejtur se përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve ishte bërë pa kritere.	I zbatuar
4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Të hyrat	Kryetari të siguroj se prona komunale ofrohet për shfrytëzim vetëm me procedura të ankandit publik. Gjithashtu, duhet të ndërmerr veprime ligjore përmes përmbauesve dhe gjykatës për mbledhjen e borxheve si dhe të formoj një komision i cili do të verifikoj të të rastet e shlyerjes së borxheve.	Nuk kemi vërejtur që prona publike është dhënë në shfrytëzim pa ankand.	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të siguroj se drejtoritë të cilat mbështesin financiarisht entitetet jo publike kanë përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare para miratimit të buxhetit vjetor. Në mbështetje të këtij plani fondet do të shpërndahen sipas prioriteteve dhe objektivave të caktuara për aktivitetet në fusha të caktuara me një kosto duke u respektuar parimi i efektivitetit dhe ekonomizimit për shpenzimet e krijuara.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që thirrjet publike për subvencionim të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, pastaj të kerkoj nga OJQ-të të dorzojnë raporte kthyesë financiare dhe narrative si dhe për çdo përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrollin dhe monitorimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të hartohen paraprakisht projektet ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara të njësisë kërkuese.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

10.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë. Gjithashtu të sigurojë përdorimin e sistemin e-pasuria nëpër të gjitha drejtoritë si dhe të hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve për rritjen e arkëtimit.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm




Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Senver Morina, Anëtar i ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS KOSOVA S ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVQ OPŠTINA ISTOG
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS PËRNGJITHSHME
LEPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Udhëzimi:
Nr. 01-06-1684 Data 01.01.2022
Viti _____ Datum _____
ISTOG-ISTOG



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

KRYETARI I KOMUNËS

DATE/DANA:	29.04.2022
REFERENCË/PREPORUKA	01 Nr.261/2022
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kombëtare të Auditimit
CC/:	z. Lavdim Maxhuni, Drejtor i Departamentit për Auditim Financiar dhe Pajtuëshmërisë
BCC/:	
NGA/OD/FROM:	Ilir Ferati, Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër e Konfirmimit për pajtuëshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Draft Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Data: 29.prill.2022, Istog,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Sinjalizimi horizontal dhe vertikal 956.00, paisje te teknologjise-printer, scanner, fotokopje 576.00, paisje te teknologjisë informative 1,360.00, ndertimi i kanalizimit ne klermine 30,000.00, renovimi i objekteve shkollore 13,135.35, ndertimi i rrugeve ne istog,rruga rinia 27,893.08, konzorciomi tech vision 40,000.00, konzorciomi tech vision 8,289.91, paisje tjera 7,470.00, shkemb shpk 40,000.00 mirëmbajtja e stadiumit të futbollit në istog 3,034.00, mirembajtja e stadiumit te futbollit istog 270.00, ndertimi i kanalizimit dhe ndriqimit publik 36,296.00, ndertimi i ndriqimit publik cerrce 19,000.00, betonimi i kanalit te ujitjes nga shkolla - lagja zeqiraj prigode 22,288.50, menti shpk 27,086.93, granit shpk 70,018.00, granit shpk 29,982.00, ndertimi i rrethojes dhe rregullimi i oborrit ne ambulancen e cerkolezit 15,272.00, shkemb shpk 34,100.09, infratek 79,892.42, betonimi i kanaleve te ujitjes ne dubove 24,969.20, ndertimi i ambulances ne fhatin uçë 3,988.00, paisje mjeksore 19,110.00, asfaltimi i rruges "regje kastrati" ne kashice 20,000.00, ndertimi i ndriqimit publik cerrce 19,000.00.
- ⁵ 1.1. udhëzimet e thirrjes për aplikantët, duke përfshirë kriteret për përzgjedhjen e përfituesve; 1.2. formularin për përshkrimin e projektit/programit; 1.3. formularin e buxhetit; 1.4. listën e plotë të dokumenteve të nevojshëm për t'u paraqitur në thirrje; 1.5. datën e hapjes dhe mbylljes së thirrjes; 1.6. të dhëna për mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve; dhe 1.7. të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes dhe kontraktimit.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.